



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr.1384/4 prot

Datë 26.07.2022

V E N D I M

K.P.P. 714/2022

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar

Në mbledhjen e datës 26.07.2022 shqyrtoi ankesën me:

Objekt:

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Company Riviera 2008” SHPK në procedurën e prokurimit “*Procedurë e Hapur*” me Nr. REF-05444-09-15-2021, me objekt “*Rikonstruksion i segmentit Hekuran Melov, degëzimi i rrugës “Late Bregu” te pallatet dykatëshe*”, me fond limit 34,008,534.7 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 08.10.2021 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Patos.

Shfuqizimi i vendimit mbi anulimin e procedurës së prokurimit të sipërcituar.

Ankimues:

“Company Riviera 2008” SHPK
Adresa: Rruga Nacionale Kamëz-Fushë Krujë, Kthesa
Valiasit Nr. 1, Kamëz.

Autoriteti Kontraktor:

Bashkia Patos

Adresa: Rruga Uzina”, Lagjja “Naftëtari”, Patos.

Baza Ligjore:

Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik” .

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:**I***Vlerësimi paraprak*

I 1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është mbi kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II*Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 16.09.2021, është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit “Procedurë e Hapur” me Nr. REF- 05444-09-15-2021, me objekt “Rikonstruksion i segmentit Hekuran Melov, degëzimi i rrugës “Late Bregu” te pallatet dykatëshe”, me fond limit

34,008,534.7 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 08.10.2021 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Patos.

II.2. Në datë 08.10.2021 autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

II.3. Nga verifikimi në sistemin e prokurimit elektronik (SPE) si dhe referuar informacionit të autoritetit kontraktor të dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, autoriteti kontraktor në datë 03.11.2021 ka kryer vlerësimin e ofertave të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

1. “Spektri” SHPK	pa ofertë ekonomike	skualifikuar
2. “ASI-2A CO” SHPK & “Armir” SHPK	22,201,924.50 lekë	skualifikuar
3. “Pepa Group” SHPK	22,969,290.86 lekë	skualifikuar
4. “Company Riviera” SHPK	25,490,478 lekë	skualifikuar
5. “Shëndëlli” SHPK	25,975,320 lekë	kualifikuar
6. “Viante Konstruksion” & “ED Konstruksion” SHPK	30,710,557.50 lekë	kualifikuar

II.4. Më datë 03.11.2021 autoriteti kontraktor nëpërmjet sistemit të prokurimeve elektronike ka njoftuar operatorin ekonomik “Company Riviera 2008” SHPK për vlerësimin e procedurës së prokurimit nga ku rezulton, se ky operator ekonomik është skualifikuar me arsyet si më poshtë vijojnë:

Ju skualifikoheni pasi: “Kriteret e veçanta të kualifikimit” Shtojca 8, nuk jepen të plotësuara të plota deklaratat, të konfirmuara ose të plotësuara aty ku e kërkon formati me të dhëna për burimin e dokumentacionit përkatës se ku e vërteton deklarinin e dhënë. Mjetet si Betoniere dhe Vibrator Betoni për të cilat janë kërkuar nga 2 copë, keni deklaruar vetëm nga 1 copë në deklaratën e mjeteve.

Nuk plotësohet pika 13.b Sigurimi i ofertës. Vlera e sigurimit të ofertës nuk është sa 2% e vlerës së fondit limit por është më pak.

II.5. Në datën 04.11.2021, është publikuar njoftimi i fituesit në Sistemin e Prokurimit Elektronik dhe në datë 08.11.2021 është publikuar njoftimi i fituesit në Buletinin Nr. 161 datë 08 Nëntor 2021, prej të cilës rezulton fitues operatorin ekonomik “Shëndëlli” SHPK.

II.6. Referuar materialeve të fashikullit të shqyrtimit administrativ rezulton, se në datën 08.11.2021 operatorin ekonomik “Company Riviera 2008” SHPK ka paraqitur njëkohësisht ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe pranë Komisionit të Prokurimit Publik. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës, u konstatua se objekti i saj lidhet me kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, mbi skualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “Company Riviera 2008” SHPK

II.7. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit nr. 2185/2 Prot., date 09.11.2021, duke referuar arsyet mbi skualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik ankimues “Company Riviera 2008” SHPK, nga procedura e prokurimit të sipërcituar.

II.8. Nëpërmjet shkresës nr. 2884/6 prot., datë 16.11.2021 protokolluar me tonën me nr. 2185/3 prot., datë 18.11.2021 është depozituar pranë Komisionin e Prokurimit Publik informacioni, dokumentacioni, si dhe vendimi mbi trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit.

II.9. Referuar shkresës së autoritetit kontraktor rezulton, se ky i fundit ka trajtuar ankesën e operatorit ekonomik ankimues “Company Riviera 2008” SHPK dhe me shkresën nr. 2884/5 prot., datë 15.11.2021 ka njoftuar operatorin ekonomik ankimues mbi vendimin e K.Sh.A nr. 2884/4 prot., datë 15.11.2021 me të cilin ka vendosur pranimin pjesërisht të ankesës, konkretisht si më poshtë vijon:

[.....]Komisioni i ngarkuar për shqyrtimin e ankesës bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga Njësia e Prokurimit si dhe në ankesën tuaj me 2584 Ptot., datë 09.11.2021 vëren se:

Në pikën 3 të ankesës suaj ju shpreheni se:

Sigurimi i ofertës. (e zbatueshme në rastin e procedurave të prokurimit me një vlerë më të lartë sesa prokurimi më vlerë të vogël). Në rastin e kontratave sektoriale, enti kontraktor, në bazë të diskrecionit të tij, mund të kërkojë sigurimin e ofertës dhe në procedurat nën kufirin e lartë monetar. Operatori ekonomik paraqet Formularin e Sigurimit të Ofertës, sipas Shtojcës 3. Shuma e kërkuar e sigurimit të ofertës është 610,170 (gjashtëqind e dhjetë mijë e njëqind e shtatëdhjetë). Nga ana e Autoriteti Kontraktor Bashkia Patos në DST për këtë procedurë prokurimi është kërkuar që shuma e sigurimit të ofertës është 610,170 (gjashtëqind e dhjetë mijë e njëqind e shtatëdhjetë). Për të përmbushur këtë kriter, si operatorë ekonomike kemi paraqitur sigurimin e ofertës në vlerën 610,170 lekë, aq sa kërkohej dhe ishte parashikuar nga vetë Autoriteti Kontraktor Bashkia Patos në DST, për t’iu përgjigjur me përpikmëri çdo kërkesë dhe kriteri të vendosur nga vetë Autoriteti Kontraktor, në Dokumentet Standarde të tenderit, të cilat janë hartuar sipas ligjit në fuqi.

Ligji nr. 162/2020, date 23.12.2020, “Për Prokurimin publik” i lë detyrimin autoritetit kontraktor për të përcaktuar në dokumentet standarde të tenderit, vlerën, vlefshmërinë dhe mundësinë e

paraqitjes së sigurimit të ofertës, dhe ne si operator ekonomik i jemi përgjegjur të gjitha kërkesave të autoritetit kontraktor, të shprehura në DST, pra është e qartë se edhe ky kriter është plotësuar nga ana jonë si operator ekonomik.

Pra as arsyeja e tretë e skualifikimit nuk qëndron dhe është në kundërshtim të plotë me ligjin nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe me vendimin e këshillit të ministrave me nr. 285, datë 19.05.2021 “Për rregullat e prokurimit publik”.

Për sa i përket pikës 3 të ankesës Komisioni i ngarkuar për shqyrtimin e ankesës bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga Njësia e Prokurimit dhe nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave vëren se:

Për përmbushjen e këtij kriteri operatori ekonomik ankimues “Company Riviera 2008” SHPK ka dorëzuar sigurimin e ofertës në vlerën e kërkuar nga Autoriteti Kontraktor duke përmbushur këtë kriter.

Sa më sipër, pretendimi i Operatorit Ekonomik në lidhje më këtë arsye skualifikimi qëndron.

Përfundimisht në mënyrë unanime ju bëjmë me dije se ankesa juaj për vlerësimin procedurës së prokurimit me objekt “Rikonstruksioni i segmentit Hekuran Melova, degëzim i rrugës “Late Bregu” e pallatet dy katësh”, do të pranohet pjesërisht për arsyet e mësipërme.[...].

II.10. Me shkresën nr. 2185/4 prot., datë 22.11.2021 Komisioni i Prokurimit Publik iu drejtua autoritetit kontraktor Bashkisë Patos me kërkesën për informacion për sa më poshtë:

“ 1. A ka paraqitur argumente pranë autoritetit tuaj kontraktor në cilësinë e operatorit ekonomik të interesuar “Shëndëlli” SHPK ?

2. A e keni njoftuar operatorin ekonomik “Shëndëlli” SHPK lidhur me vendimmarrjen e autoritetit tuaj kontraktor mbi trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues “Company Riviera 2008” SHPK ?

II.11. Me shkresën nr. 3054/1 prot., datë 26.11.2021 protokolluar me tonën nr. 2185/5 prot., 01.12.2021 autoriteti kontraktor Bashkia Patos njofton Komisionin e Prokurimit Publik se:

“ 1. Operatori Ekonomik “Shëndëlli” SHPK nuk ka paraqitur argumente pranë autoritetit kontraktor Bashkia Patos në cilësinë operatorit ekonomik të interesuar.

2. *Operatori Ekonomik "Shëndëlli" SHPK është njoftuar me shkresën nr. 2884/7 prot, datë 16.11.2021 në lidhje me vendimmarrjen e autoritetit kontraktor Bashkia Patos mbi trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues "Company Riviera 2008" SHPK.*

II.12. Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në dosjen e shqyrtimit administrativ, si dhe bazuar në informacionin e Autoritetit Kontraktor, u konstatua se nuk ka pasur pretendime nga subjekte të interesuara, në përputhje me nenin 113 ligji Nr. 162/2020 për prokurimin publik.

II.13. Në datën 20.12.2021 me vendimin nr. 1018/2021 Komisioni i Prokurimit Publik ka vendosur:

1. *Të pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik "Company Riviera 2008" SHPK për procedurën e prokurimit "Procedurë e Hapur" me Nr. REF- 05444-09-15-2021, me objekt "Rikonstruksion i segmentit Hekuran Melov, degëzimi i rrugës "Late Bregu" te pallatet dykatëshe", me fond limit 34,008,534.7 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 08.10.2021 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Patos.*
2. *Autoriteti kontraktor të anulojë vendimin e KVO-së mbi skualifikimin e operatorit ekonomik "Company Riviera 2008" SHPK, duke e kualifikuar këtë operator.*
3. *Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.*
4. *Ngarkohet zyra e financës të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik "Company Riviera 2008" SHPK.*
5. *Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.*

II.14. Me shkresën nr. 2884/14 prot., datë 30.12.2021, protokolluar me tonën nr. 2185/9 prot., datë 05.01.2022, autoriteti kontraktor *Bashkia Patos*, informon se ka zbatuar vendimin Nr. 1018/2021, datë 20.12.2021, të Komisionit të Prokurimit Publik, për procedurën e prokurimit "*Procedurë e Hapur*" me Nr. REF- 05444-09-15-2021, me objekt "*Rikonstruksion i segmentit Hekuran Melov, degëzimi i rrugës "Late Bregu" te pallatet dykatëshe*", me fond limit 34,008,534.7 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 08.10.2021 nga autoriteti kontraktor, *Bashkia Patos*. Nga verifikimet e kryera në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, konstatohet, se autoriteti kontraktor ka kryer rivlerësimin në datën 30.12.2021, duke kualifikuar operatorin ekonomik ankimues "*Company Riviera 2008*" SHPK sipas përcaktimeve në vendimin K.P.P 1018/2021.

II.15. Me vendimin nr.08/2022 datë 07.01.2022 Komisioni i Prokurimit Publik ka vendosur:

1. *Të lejojë autoritetin kontraktor për vijimin me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit "Procedurë e Hapur" me Nr. REF- 05444-09-15-2021, me objekt "Rikonstruksion i segmentit Hekuran Melov, degëzimi i rrugës "Late Bregu" te pallatet*

dykatëshe”, me fond limit 34,008,534.7 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 08.10.2021 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Patos.

II.16. Në datën 18.01.2022, është publikuar njoftimi i fituesit në Sistemin e Prokurimit Elektronik prej të cilës rezulton fitues operatori ekonomik “Company Riviera 2008” SHPK.

II.17. Në datën 25.03.2021 operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit janë njoftuar elektronikisht mbi klasifikimin e ofertave si vijon:

- “Spektri” SHPK	pa ofertë ekonomike	skualifikuar
- “ASI-2A CO” SHPK & “Armir” SHPK	22,201,924.50 lekë	skualifikuar
- “Pepa Group” SHPK	22,969,290.86 lekë	skualifikuar
- “Company Riviera” SHPK	25,490,478 lekë	skualifikuar
- “Shëndëlli” SHPK	25,975,320 lekë	skualifikuar
- “Viante Konstruksion” & “ED Konstruksion” SHPK	30,710,557.50 lekë	skualifikuar

II.18. Më datë 25.03.2022 autoriteti kontraktor, nëpërmjet sistemit të prokurimeve elektronike, ka njoftuar operatorin ekonomik “Company Riviera 2008” SHPK për vlerësimin e procedurës së prokurimit nga ku rezulton, se ky operator ekonomik është skualifikuar me arsyet si më poshtë vijojnë:

- ***Pas verifikimit të dokumenteve origjinal nga ana e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave u konstatuan këto mangësi:***

Në Kriteret e Veçanta të Kualifikimit Pika 2.3.5. thuhet se:

Operatori ekonomik duhet të disponojë punonjës të specializuar/ të kualifikuar, si më poshtë”

- *a. Teknik Ndërtimi 1(një) për këtë duhet të paraqes: Diplomë të shkollës së mesme, kontratë pune të vlefshme, dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik (të vlefshme) IQT (ose ekuivalente), dhe të figuroj në listpagesën e shoqërisë nga muaji Qershor 2021 e në vazhdim.*

Operatori në vetëdeklarim ka deklaruar si teknik ndërtimi Hamdi Pasha. Pas kontrollit të dokumenteve fizike rezulton se mungon dokumenti i diplomës së shkollës së mesme.

- *f. Manovratore 3(tre) për këtë duhet të paraqes, kontratë pune të vlefshme, leje drejtimi, dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik (të vlefshme) IQT (ose ekuivalente), dhe të figuroj në listpagesën e shoqërisë nga muaji Qershor 2021 e në vazhdim. Të 3 manovratorët e deklaruar Andi Hyka, Ibrahim Pata, Angjelin Prendi u mungon leja e drejtimit.*

- *Në Kriteret e Veçanta të Kualifikimit Pika 2.3.6 dhe 2.3.7. operatori ekonomik duhet të disponoj mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:*
 - *Kamion me aftësi mbajtëse (8 deri në 10 ton)_copë 2 •*
 - *Gjenerator 3.5Kë_copë 2*

Pas verifikimit të dokumentacionit të mjeteve rezulton se njëri nga kamionët e deklaruar me aftësi mbajtëse 8-10 ton, Kamioni me targa AB394DD, ka aftësi mbajtëse 10 155kg, pra është më shumë se tonazhi i kërkuar. Po ashtu njëri nga gjeneratorët e deklaruar me fuqi 3.5Kë, gjeneratori 3.5Kë i Fat.nr. 48039 dt.28.07.2009 është 3.2 Kë dhe jo 3.5 Kë që kërkohet.

II.19. Në datën 29.03.2021 autoriteti kontraktor ka publikuar aktin e Njoftim-Anulimit në Sistemin e Prokurimeve Elektronik.

II.20. Në datën 04.04.2022 në Sistemin e Ankesave Elektornike të Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me nr.692/2022 protokolli dhe me numër ankimi elektronik A/2022/2036 e operatorit ekonomik “COMPANY RIVIERA 2008” SHPK për procedurën e prokurimit objekt-ankimi. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës, u konstatua se objekti i saj lidhet me kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, mbi skualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “COMPANY RIVIERA 2008” SHPK nga procedura e prokurimit të sipërcituar.

II.21. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit nr. 692/2 Prot., date 05.04.2022, duke referuar arsyet mbi skualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik ankimues “Company Riviera 2008” SHPK, nga procedura e prokurimit të sipërcituar.

II.22. Nëpërmjet shkresës nr. 2324/32 prot., datë 12.04.2022 protokolluar me tonën me nr. 692/3 prot., datë 15.04.2022 është depozituar pranë Komisionin e Prokurimit Publik informacioni, dokumentacioni, si dhe vendimi mbi trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit, ku rezulton se është vendosur pranimi pjesërisht i ankesës si më poshtë:

- *Lidhur me arsyen e skualifikimit pika f. Manvratore 3(tre) për këtë duhet të paraqesë, kontratë pune të vlefshme, leje drejtimi, dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik (të vlefshme) IQT (ose ekuivalente), dhe te figuroj në listpagesën e shoqërisë nga muaji Qershor 2021 e në vazhdim. Të 3 manvratoret e deklaruar Andi Hyka, Ibrahim Pata, Angjelin Prendi u mungon leja e drejtimit, KSHA vëren se nga vlerësimi i*

dokumentacionit fizik të paraqitur për 3 manovratorët e deklaruar A.H, I.P dhe A.P u konstatua se për të tre manovratorët janë paraqitur dokumentacion i plotë si kontratë pune e vlefshme, leje drejtimi për manovratorët , leja e drejtimit i referohet dëshmisë së aftësisë profesionale si dhe dëshmia e sigurimit teknik. Kjo pikë e ankesës suaj pranohet.

II.23. Me vendimin nr.357/2022 datë 20.04.2022 Komisioni i Prokurimit Publik ka vendosur:

- 1. Të mbyllë çështjen për pjesën e pranuar të ankesës së operatorit ekonomik “COMPANY RIVIERA 2008” SHPK për procedurën e prokurimit E hapur”, me Nr. REF-05444-09-15-2021, me objekt “Rikonstruksioni i segmentit Hekuran Melova, degëzim i rrugës “Late Bregu” te pallatet dy katësh”, me fond limit 34,008,534.7 lekë pa TVSh, zhvilluar më datë 08.10.2022, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Patos.*
- 2. Të vazhdojë procedurën e shqyrtimit në themel për pjesën tjetër të ankesës.*
- 3. Kopje e këtij vendimi ti dërgohet Agjencisë së Prokurimit Publik.*

II.24. Me vendimin nr.397/2022 datë 29.04.2022 Komisioni i Prokurimit Publik ka vendosur:

- 1. Të pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Company Riviera 2008” SHPK, për procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur” me Nr. REF-05444-09-15-2021, me objekt “Rikonstruksion i segmentit Hekuran Melov, degëzimi i rrugës “Late Bregu” te pallatet dykatëshe”, me fond limit 34,008,534.7 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 08.10.2021 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Patos.*
- 2. Autoriteti kontraktor të anulojë vendimin e KVO-së mbi skualifikimin e operatorit ekonomik “Company Riviera 2008” SHPK, si dhe të korrigjojë shkeljet, duke e kualifikuar këtë operator.*
- 3. Autoriteti kontraktor brenda 5 ditëve të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.*
- 4. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Company Riviera 2008” SHPK.*
- 5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.*

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

II.25. Në datën 05.05.2022 autoriteti kontraktor ka kryer në sistemin e prokurimeve elektronike procesin e rivlerësimit të procedurës si më poshtë:

- | | | |
|----------------------------------|---------------------|--------------|
| - “Spektri” SHPK | pa ofertë ekonomike | skualifikuar |
| - “ASI-2A CO”SHPK & “Armir” SHPK | 22,201,924.50 lekë | skualifikuar |

- “Pepa Group” SHPK	22,969,290.86 lekë	skualifikuar
- “Company Riviera” SHPK	25,490,478 lekë	I kualifikuar
- “Shëndëlli” SHPK	25,975,320 lekë	skualifikuar
- “Viante Konstruksion” & “ED Konstruksion” SHPK	30,710,557.50 lekë	skualifikuar

II.26. Referuar parashtrimeve në ankesë rezulton, se në datën 09.06.2022 në faqen zyrtare të prokurimeve në rubrikën kërkesa nga autoriteti kontraktor, i është dërguar kërkesë operatorit ekonomik ankimues për paraqitje dokumentacioni provues të vetëdeklaruar në formularin e vetëdeklarimit dhe të dokumenteve të tjerë shoqërues të ofertës. Në datën 13.06.2022 me shkresën nr.74 prot ankimuesi ka dorëzuar në Bashkinë Patos dokumentacionin provues për vetëdeklarimet e bëra në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit.

II.27. Në datën 23.06.2022 autoriteti kontraktor, nëpërmjet sistemit të prokurimeve elektronike, ka njoftuar operatorin ekonomik “Company Riviera 2008” SHPK për rivlerësimin e procedurës së prokurimit nga ku rezulton, se ky operator ekonomik është skualifikuar me arsyet si më poshtë vijojnë:

- *Nuk plotëson pikën 2.3.5 në DT mbi disponimin e punonjësve të specializuar pasi tekniku i ndërtimit i deklaruar për këtë procedurë Z.H.P nuk disponon diplomë të shkollës së mesme për teknik ndërtimi por vetëm certifikim si teknik ndërtimi të lëshuar nga ASHP i cili nuk konsiderohet i vlefshëm apo i barasvlershëm pasi në DT nuk përcaktohet diplomë e shkollës së mesme ose ekuivalente por vetëm diplomë e shkollës së mesme.*
- *Nuk plotëson pikën 2.3.7 në DT mbi disponimin e mjeteve dhe pajisjeve pasi:
Kontrata e shitblerjes së mjetit tip asfaltoshtruese me nr. shasise CATBB730VB2K232 me palë shitëse shoqërinë Albabras ShPK nuk është lidhur para noterit ndërkohë që duhet kontratë noteriale sipas përcaktimeve në DT.
Mjetet tip kamion me aftësi mbajtëse 8-10 ton me targë përkatësisht AB394DD dhe TR9708P të siguruara me kontratë huapërdorje nga shoqëria Agri Construction janë të pajisur me certifikatë transporti vetëm për llogari të vet dhe jo për të tretë/qira.*
- *Për pajisjen e kërkuar prerëse pllaka betoni janë paraqitur dy fatura , fatura nr.06 datë 02.11.2020ky pasqyrohet blerja nga shoqëria ASI invest e një prerëse pllakash (e papërcaktuar) pra është prerëse pllakash të zakonshme jo betoni si dhe fatura me nr.243 datë 08.05.2019 ku pasqyrohet blerja e një share asfalti të kompletuar (Në DT nuk është kërkuar dhe nuk është ekuivalente me prerëse pllakash betoni). Mungojnë foto të pajisjes.*
- *Gjeneratori i paraqitur në faturën Nr.R48039 datë 28.07.2009 është i fuqisë 4kVA e konvertuar në 3.2 KË pra nuk plotëson kushtin e një gjeneratori 3.5KË që kërkohet në DT.*

II.28. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton, se në datën 24.06.2022 autoriteti kontraktor ka vendosur anulimin e procedurës së prokurimit objekt-ankimi.

II.29. Në datën 29.06.2022 nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me nr. 1384 protokoli, datë 29.06.2022 dhe me numër ankimi elektronik A/2022/2312 e operatorit ekonomik “Riviera Company” SHPK për procedurën e “Procedurë e Hapur” me Nr. REF-05444-09-15-2021, me objekt “Rikonstruksioni i segmentit Hekuran Melova, degëzim i rrugës “Late Bregu” te pallatet dy katësh” me fond limit 34,008,534.7 (tridhjetë e katër milion e tetë mijë e pesëqind e tridhjetë e katër pikë shtatë) lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 08.10.2021 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Patos. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik ankimes “Riviera Company” SHPK, si dhe kërkohet shfuqizimi i vendimit të autoritetit kontraktor mbi anulimin e procedurës së prokurimit objekt-ankimi.

II.30. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit nr. 1384/2 Prot., datë 30.06.2022 duke referuar arsyet e skualifikimit të ofertës së operatorit ekonomik ankimes “Company Riviera 2008” SHPK, nga procedura e prokurimit të sipërcituar.

II.31. Nëpërmjet shkresës nr1648/6 datë 06.07.2022 protokolluar me tonën me nr. 1384/3 prot., datë 08.07.2022 është depozituar pranë Komisionin e Prokurimit Publik informacioni, dokumentacioni, si dhe vendimi mbi trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimes, ku rezulton se është vendosur pranimi pjesërisht i ankesës lidhur me arsyen e fundit të skualifikimit *Gjeneratori i paraqitur në faturën Nr.R48039 datë 28.07.2009 është i fuqisë 4kVA e konvertuar në 3.2 KË pra nuk plotëson kushtin e një gjeneratori 3.5KË që kërkohet në DT.*

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dhe dokumentacionit bashkëngjitur saj,

Arsyeton

III.1. Në datën **20.12.2021** me vendimin nr. 1018/2021 Komisioni i Prokurimit Publik ka vendosur:

1. *Të pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Company Riviera 2008” SHPK për procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur” me Nr. REF- 05444-09-15-2021, me objekt “Rikonstruksion i segmentit Hekuran Melov, degëzimi i rrugës “Late*

Bregu” te pallatet dykatëshe”, me fond limit 34,008,534.7 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 08.10.2021 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Patos.

2. *Autoriteti kontraktor të anulojë vendimin e KVO-së mbi skualifikimin e operatorit ekonomik “Company Riviera 2008” SHPK, duke e kualifikuar këtë operator.*
3. *Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.*
4. *Ngarkohet zyra e financës të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Company Riviera 2008” SHPK.*
5. *Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.*

III.1.2. Me shkresën nr. 2884/14 prot., datë 30.12.2021, protokolluar me tonën nr. 2185/9 prot., datë 05.01.2022, autoriteti kontraktor *Bashkia Patos*, informon se ka zbatuar vendimin Nr. 1018/2021, datë 20.12.2021, të Komisionit të Prokurimit Publik, për procedurën e prokurimit “*Procedurë e Hapur*” me Nr. REF- 05444-09-15-2021, me objekt “*Rikonstruksion i segmentit Hekuran Melov, degëzimi i rrugës “Late Bregu” te pallatet dykatëshe*”, me fond limit 34,008,534.7 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 08.10.2021 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Patos. Nga verifikimet e kryera në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, konstatohet, se autoriteti kontraktor ka kryer rivlerësimin në datën 30.12.2021, duke kualifikuar operatorin ekonomik ankimes “*Company Riviera 2008*” SHPK sipas përcaktimeve në vendimin K.P.P 1018/2021.

III.1.3. Me vendimin nr.08/2022 datë 07.01.2022 Komisioni i Prokurimit Publik ka vendosur:

1. *Të lejojë autoritetin kontraktor për vijimin me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit “Procedurë e Hapur” me Nr. REF- 05444-09-15-2021, me objekt “Rikonstruksion i segmentit Hekuran Melov, degëzimi i rrugës “Late Bregu” te pallatet dykatëshe”, me fond limit 34,008,534.7 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 08.10.2021 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Patos.*

III.1.4. Në datën **18.01.2022**, është publikuar njoftimi i fituesit në Sistemin e Prokurimit Elektronik prej të cilës rezulton fitues operatori ekonomik “*Company Riviera 2008*” SHPK.

III.1.5. Në datën **25.03.2021** operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit janë njoftuar elektronikisht mbi klasifikimin e ofertave si vijon:

- “Spektri” SHPK	pa ofertë ekonomike		skualifikuar
- “ASI-2A CO” SHPK & “Armir” SHPK	22,201,924.50 lekë		skualifikuar
- “Pepa Group” SHPK	22,969,290.86 lekë		skualifikuar
- “ Company Riviera ” SHPK	25,490,478 lekë		skualifikuar
- “Shëndëlli” SHPK	25,975,320 lekë		skualifikuar

- “Viante Konstruksion” & “ED Konstruksion” SHPK 30,710,557.50 lekë skualifikuar

III.1.6. Më datë 25.03.2022 autoriteti kontraktor nëpërmjet sistemit të prokurimeve elektronike ka njoftuar operatorin ekonomik “Company Riviera 2008” SHPK për vlerësimin e procedurës së prokurimit nga ku rezulton, se ky operator ekonomik është skualifikuar me arsyet si më poshtë vijojnë:

- ***Pas verifikimit të dokumenteve original nga ana e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave u konstatuan këto mangësi:***

Në Kriteret e Veçanta të Kualifikimit Pika 2.3.5. thuhet se:

Operatori ekonomik duhet të disponojë punonjës të specializuar/ të kualifikuar, si më poshtë”

- *a. Teknik Ndërtimi 1(një) për këtë duhet të paraqes: Diplomë të shkollës së mesme, kontratë pune të vlefshme, dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik (të vlefshme) IQT (ose ekuivalente), dhe të figuroj në listpagesën e shoqërisë nga muaji Qershor 2021 e në vazhdim.*

Operatori në vetëdeklarim ka deklaruar si teknik ndërtimi Hamdi Pasha. Pas kontrollit të dokumenteve fizike rezulton se mungon dokumenti i diplomës së shkollës së mesme.

- *f. Manovratore 3(tre) për këtë duhet të paraqes, kontratë pune të vlefshme, leje drejtimi, dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik (të vlefshme) IQT (ose ekuivalente), dhe të figuroj në listpagesën e shoqërisë nga muaji Qershor 2021 e në vazhdim. Të 3 manovratorët e deklaruar Andi Hyka, Ibrahim Pata, Angjelin Prendi u mungon leja e drejtimit.*

- *Në Kriteret e Veçanta të Kualifikimit Pika 2.3.6 dhe 2.3.7. operatori ekonomik duhet të disponoj mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:*

- *Kamion me aftësi mbajtëse (8 deri në 10 ton)_copë 2 •*

- *Gjenerator 3.5Kë_copë 2*

Pas verifikimit të dokumentacionit të mjeteve rezulton se njëri nga kamionët e deklaruar me aftësi mbajtëse 8-10 ton, Kamioni me targa AB394DD, ka aftësi mbajtëse 10 155kg, pra është më shumë se tonazhi i kërkuar. Po ashtu njëri nga gjeneratorët e deklaruar me fuqi 3.5Kë, gjeneratori 3.5Kë i Fat.nr. 48039 dt.28.07.2009 është 3.2 Kë dhe jo 3.5 Kë që kërkohet.

III.1.7. Në datën **29.03.2021**, autoriteti kontraktor ka publikuar aktin e Njoftim-Anulimit në Sistemin e Prokurimeve Elektronike.

III.1.8. Në datën 04.04.2022 në Sistemin e Ankesave Elektronike të Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me nr.692/2022 protokolli dhe me numër ankimi elektronik

A/2022/2036 e operatorit ekonomik “COMPANY RIVIERA 2008” SHPK për procedurën e prokurimit objekt-ankimi. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës, u konstatua se objekti i saj lidhet me kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, mbi skualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “COMPANY RIVIERA 2008” SHPK nga procedura e prokurimit të sipërcituar.

III.1.9. Me vendimin nr.397/2022 datë 29.04.2022 Komisioni i Prokurimit Publik ka vendosur:

1. Të pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Company Riviera 2008” SHPK, për procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur” me Nr. REF-05444-09-15-2021, me objekt “Rikonstruksion i segmentit Hekuran Melov, degëzimi i rrugës “Late Bregu” te pallatet dykatëshe”, me fond limit 34,008,534.7 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 08.10.2021 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Patos.
2. Autoriteti kontraktor të anulojë vendimin e KVO-së mbi skualifikimin e operatorit ekonomik “Company Riviera 2008” SHPK, si dhe të korrigjojë shkeljet, duke e kualifikuar këtë operator.
3. Autoriteti kontraktor brenda 5 ditëve të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
4. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Company Riviera 2008” SHPK.
5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

III.1.10. Në datën 05.05.2022 autoriteti kontraktor ka kryer në sistemin e prokurimeve elektronike procesin e rivlerësimit të procedurës si më poshtë:

- | | | |
|--------------------------------------------------|---------------------|---------------|
| - “Spektri” SHPK | pa ofertë ekonomike | skualifikuar |
| - “ASI-2A CO” SHPK & “Ardmir” SHPK | 22,201,924.50 lekë | skualifikuar |
| - “Pepa Group” SHPK | 22,969,290.86 lekë | skualifikuar |
| - “Company Riviera” SHPK | 25,490,478 lekë | I kualifikuar |
| - “Shëndëlli” SHPK | 25,975,320 lekë | skualifikuar |
| - “Viante Konstruksion” & “ED Konstruksion” SHPK | 30,710,557.50 lekë | skualifikuar |

III.1.11. Me shkresën nr.2324/45 prot datë 24.05.2022, protokolluar me tonën nr. 692/9 prot., datë 27.05.2022 autoriteti kontraktor, Bashkia Patos, informon se ka zbatuar vendimin Nr. 397/2022 datë 29.04.2022 të Komisionit të Prokurimit Publik, për procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur” me Nr. REF-05444-09-15-2021, me objekt “Rikonstruksion i segmentit Hekuran Melov, degëzimi i rrugës “Late Bregu” te pallatet dykatëshe”, me fond limit

34,008,534.7 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 08.10.2021 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Patos.

II.2. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike, si edhe nga informacioni i autoritetit kontraktor depozituar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, konstatohet se, autoriteti kontraktor ka kualifikuar operatorin ekonomik “Company Riviera 2008” SHPK në përputhje me pikën 3 të dispozitivit të vendimit Nr. 397/2022 datë 29.04.2022.

III.1.12. Me vendimin nr.520/2022 datë 01.06.2022 Komisioni i Prokurimit Publik ka vendosur:

- *Të lejojë autoritetin kontraktor për vijimin me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit “Procedurë e Hapur” me Nr. REF-05444-09-15-2021, me objekt “Rikonstruksion i segmentit Hekuran Melov, degëzimi i rrugës “Late Bregu” te pallatet dykatëshe”, me fond limit 34,008,534.7 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 08.10.2021 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Patos.*

III.1.13. Referuar parashtrimeve në ankesë rezulton se në datën 09.06.2022 në faqen zyrtare të prokurimeve në rubrikën kërkesa nga autoriteti kontraktor i është dërguar kërkesë operatorit ekonomik ankimues për paraqitje dokumentacioni provues të vetëdeklaruar në formularin e vetëdeklarimit dhe të dokumenteve të tjera shoqëruese të ofertës. Në datën 13.06.2022 me shkresën nr.74 prot ankimuesi ka dorëzuar në Bashkinë Patos dokumentacionin provues për vetëdeklarimet e bëra në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit.

III.1.14. Në datën 23.06.2022 autoriteti kontraktor, nëpërmjet sistemit të prokurimeve elektronike, ka njoftuar operatorin ekonomik “Company Riviera 2008” SHPK për rivlerësimin e procedurës së prokurimit nga ku rezulton, se ky operator ekonomik është skualifikuar me arsyet si më poshtë vijojnë:

- *Nuk plotëson pikën 2.3.5 në DT mbi disponimin e punonjësve të specializuar pasi tekniku i ndërtimit i deklaruar për këtë procedurë Z.H.P nuk disponon diplomë të shkollës së mesme për teknik ndërtimi por vetëm certifikim si teknik ndërtimi të lëshuar nga ASHP i cili nuk konsiderohet i vlefshëm apo i barasvlefshëm pasi në DT nuk përcaktohet diplomë e shkollës së mesme ose ekuivalente por vetëm diplomë e shkollës së mesme.*
- *Nuk plotëson pikën 2.3.7 në DT mbi disponimin e mjeteve dhe pajisjeve pasi:
Kontrata e shitblerjes së mjetit tip asfaltoshtruese me nr. shasise CATBB730VB2K232 me palë shitëse shoqërinë Albabras ShPK nuk është lidhur para noterit ndërkohë që duhet kontratë noteriale sipas përcaktimeve në DT.
Mjetet tip kamion me aftësi mbajtëse 8-10 ton me targë përkatësisht AB394DD dhe TR9708P të siguruara me kontratë huapërdorje nga shoqëria Agri Construction janë të pajisur me certifikatë transporti vetëm për llogari të vet dhe jo për të tretë/qira.*
- *Për pajisjen e kërkuar prerëse pllaka betoni janë paraqitur dy fatura , fatura nr.06 datë 02.11.2020ky pasqyrohet blerja nga shoqëria ASI invest e një prerëse pllakash (e*

papërcaktuar) pra është prerëse pllakash të zakonshme jo betoni si dhe fatura me nr.243 datë 08.05.2019 ku pasqyrohet blerja e një share asfalti të kompletuar (Në DT nuk është kërkuar dhe nuk është ekuivalente me prerëse pllakash betoni). Mungojnë foto të pajisjes.

- *Gjeneratori i paraqitur në faturën Nr.R48039 datë 28.07.2009 është i fuqisë 4kVA e konvertuar në 3.2 KË pra nuk plotëson kushtin e një gjeneratori 3.5KË që kërkohet në DT.*

III.1.15. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton se në datën 24.06.2022 autoriteti kontraktor ka vendosur anulimin e procedurës së prokurimit objekt-ankimi.

III.1.16. Në datën 29.06.2022 nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me nr. 1384 protokoli, datë 29.06.2022 dhe me numër ankimi elektronik A/2022/2312 e operatorit ekonomik “Riviera Company” SHPK për procedurën e “Procedurë e Hapur” me Nr. REF-05444-09-15-2021, me objekt “Rikonstruksioni i segmentit Hekuran Melova, degëzim i rrugës “Late Bregu” te pallatet dy katësh” me fond limit 34,008,534.7 (tridhjetë e katër milion e tetë mijë e pesëqind e tridhjetë e katër pikë shtatë) lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 08.10.2021 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Patos. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik ankimues “Riviera Company” SHPK, si dhe kërkohet shfuqizimi i vendimit të autoritetit kontraktor mbi anulimin e procedurës së prokurimit objekt-ankimi.

III.1.17. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit nr. 1384/2 Prot., datë 30.06.2022 duke referuar arsyet e skualifikimit të ofertës së operatorit ekonomik ankimues “Company Riviera 2008” SHPK, nga procedura e prokurimit të sipërcituar.

III.1.18. Nëpërmjet shkresës nr1648/6 datë 06.07.2022 protokolluar me tonën me nr. 1384/3 prot., datë 08.07.2022 është depozituar pranë Komisionin e Prokurimit Publik informacioni, dokumentacioni, si dhe vendimi mbi trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues, ku rezulton se është vendosur pranimi pjesërisht i ankesës lidhur me arsyen e fundit të skualifikimit *Gjeneratori i paraqitur në faturën Nr.R48039 datë 28.07.2009 është i fuqisë 4kVA e konvertuar në 3.2 KË pra nuk plotëson kushtin e një gjeneratori 3.5KË që kërkohet në DT.*

III.1.19 Në pikat 1 dhe 2 të nenit 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” përcaktohet se: “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, **autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake** në

vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, **formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji.** Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik. Kur autoriteti ose enti kontraktor mund t'i marrë dokumentet mbështetëse duke u futur direkt në një bazë të aksesueshme të dhënash shtetërore, në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit përcaktohet edhe informacioni që kërkohet për këtë qëllim, siç është adresa në internet e bazës të të dhënave, çdo e dhënë identifikimi dhe, sipas rastit, në deklaratën e nevojshme për dhënien e pëlqimit. Operatorët ekonomikë mund të përdorin një formular vetëdeklarimi që është përdorur gjatë një procedure prokurimi të mëparshme, nëse informacioni që ajo përmban vazhdon të jetë i saktë dhe i vlefshëm.

2. Në çdo kohë gjatë procedurës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë ofertuesve dhe kandidatëve sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, kur kjo është e nevojshme për të garantuar zbatimin korrekt të procedurës.

III.1.20. Në nenin 26 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, pikat 1, 2, 3, 6 dhe 7 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, **autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.**

2. Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit përmban informacion dhe deklarinimin, si më poshtë vijon:

a) operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin ose sipas legjislacionit të posaçëm, në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;

b) operatori ekonomik nuk është dënuar për asnjë nga veprat penale, të parashikuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;

c) personi/at në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose që ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, nuk është ose ka qenë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për asnjë nga veprat penale, të përcaktuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;

ç) operatori ekonomik nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale;

d) operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi;

dh) operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e taksave dhe tatimeve 1 të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 76, të LPP-së;

- e) operatori ekonomik ka shlyer të gjitha detyrimet e maturuara të energjisë elektrike, dhe përmbush kërkesat që rrjedhin nga legjislacioni i fushës në fuqi. Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët ushtrojnë veprimtarinë në territorin e Republikës së Shqipërisë;
- ë) operatori ekonomik nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- f) operatori ekonomik ushtron aktivitetin në zbatim të kërkesave ligjore të legjislacionit mjedisor, social dhe të punës;
- g) operatori ekonomik ka paraqitur ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- gj) operatori ekonomik përmbush specifikimet teknike, sipas kërkesave të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor;
- h) operatori ekonomik disponon fuqinë punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor (kur është rasti);
- i) operatori ekonomik disponon mjetet dhe makineritë e nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor, kur është rasti;
- j) informacion mbi subjektet, mbi kapacitetet e të cilave, operatori ekonomik do të mbështetet, nëse është rasti dhe nënkontraktorët e mundshëm, nëse është rasti;
- k) operatori ekonomik ushtron aktivitetin konform kërkesave të legjislacionit në fuqi.

3. Informacioni i pasqyruar në formularin e vetëdeklarimit, i cili gjendet në një bazë të dhënash, ku autoriteti/enti kontraktor mund të aksesojë direkt këtë informacion dhe /ose dokumentin, duhet të shoqërohet me adresën përkatëse për këtë bazë të dhënash.

4. Për përmbushjen e detyrimit sipas këtij neni, operatorët ekonomikë mund të përdorin një formular vetëdeklarimi që është përdorur gjatë një procedure prokurimi të mëparshme, nëse informacioni që ajo përmban vazhdon të jetë i saktë dhe i vlefshëm.

5. Operatorëve ekonomikë nuk u kërkohet të dorëzojnë dokumente mbështetëse, kur autoriteti ose enti kontraktor që ka dhënë kontratën ose ka lidhur marrëveshjen kuadër, i ka këto dokumente.

6. Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.

III.1.21. Në interpretim të sa më sipër KPP gjykon, se autoriteti kontraktor ka detyrimin t'i kërkojë ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin. Në rastin konkret KPP vërën, se momenti procedural i kërimit të dokumenteve origjinale dhe verifikimi i tyre nga ana e autoritetit kontraktor për operatorin ekonomik “COMPANY RIVIERA 2008” SHPK, ka qenë minimumi

data **30.12.2021**, datë në të cilën ankimuesi është kualifikuar në sistemin e prokurimeve elektronike dhe maksimumi data **18.01.2022**, datë në të cilën është bërë publikimi i njoftimit në Sistemin e Prokurimit Elektronik për operatorin ekonomik “Company Riviera 2008” SHPK. Sikundër rezulton në faktet e parashtruara më sipër, autoriteti kontraktor nuk ka kërkuar përgjatë kësaj periudhe nga ana e ofertuesit të kualifikuar dorëzimin e dokumentacionit origjinal dhe verifikimin e kapaciteteve të cilat ishin përmbushur deri në atë moment me anë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit. KPP vëren, se në dokumentacionin bashkëngjitur ankesës nga ana e ankimuesit gjendet shkresa nr.2324/16 datë 10.02.2022 e Bashkisë Patos me lëndë mbi kontrollin e dokumenteve fizike për procedurën e prokurimit objekt-ankimi drejtuar ankimuesit dhe për dijeni Komisionit të Prokurimit Publik. Në këtë shkresë citohet se: ***Me shkresën nr.2324/11 prot datë 17.01.2022 Bashkia Patos ka bërë Njoftim-Fituesi për operatorin Company Riviera 2008. Me shkresën nr.2334/13 prot datë 20.01.2022 operatori i kualifikuar Compani Rivirea 2008 ka sjellë dosjen fizike me dokumentacionin origjinal.*** Ndërkohë pas këtij momenti, KPP vëren, se rivlerësimi i procedurës dhe skualifikimi sërish i operatorit ekonomik ankimues Company Rivera 2008 nga ana e autoritetit kontraktor, është bërë më datë 25.03.2022, pra për afro dy muaj nga momenti në të cilin autoriteti kontraktor supozon se ka kryer verifikimin e dokumentacionit fizik të dorëzuar nga ankimuesi, i cili sikundër pasqyruar edhe në vetë shkresën e autoritetit kontraktor, është bërë pas publikimit të njoftimit në sistemin e prokurimeve elektronike, në shkelje të pikës 6 të nenit 26 të VKM nr. 285 datë 9.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

Akoma më tej, edhe pas vendimit nr. 397/2022 datë 29.04.2022 të Komisionit të Prokurimit Publik, autoriteti kontraktor edhe pse fillimisht ka vijuar me zbatimin e vendimit dhe kualifikimin e ankimuesit ka vijuar të kryejë të njëjtat shkelje procedurale duke kërkuar sërish paraqitjen e dokumentacionit origjinal në funksion të provueshmërisë së vetëdeklarimeve në Formularin Përmbledhës të vetëdeklarimit. Edhe pse në arsyetimin e vendimit nr.397/2022 datë 29.04.2022 KPP ka gjykuar, se momenti procedural për kërkim dokumentacioni origjinal ka kaluar për autoritetin kontraktor, ky i fundit ka kërkuar sërish në mënyrë të përsëritur dokumentacionin origjinal dhe ka kryer rivlerësime të vazhdueshme në shkelje të dispozitave ligjore në fuqi.

Komisioni i Prokurimit Publik rithekson edhe njëherë faktin, se përcaktimi i procedurave dhe afateve të caktuara procedurale në LLP dhe Rregullat e Prokurimit Publik, duke filluar nga afati për përgatitjen e ofertës, afati i shqyrtimit të ofertave, afati i ankimimit etj, apo akoma më tej dhe afatet për verifikim të parashikuara shprehimisht në ligj, përfaqësojnë garanci dhe siguri juridike për palët e interesuara. Parimi i ligjshmërisë është ndër parimet kryesore të veprimtarisë së organeve të administratës publike. Gjithashtu, ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurave të prokurimit, parashikuar nga *lex specialis* LPP, në nenin 2 të tij, janë ato të mosdiskriminimit, transparencës dhe barazisë. Tërësia e elementeve të mësipërme lidhet ngushtësisht me elemente të ligjshmërisë së vendimeve të organeve të administratës publike. Gjithashtu KPP gjykon, se ligjvënësi ka parashikuar afate strikte kohore për zhvillimin e procedurave të prokurimit në

përgjithësi dhe në veçanti në lidhje me institutin e ankimit administrativ, të rishikimit të vendimmarrjes së autoritetit kontraktor. KPP gjykon, se autoriteti kontraktor ka gabuar në zbatimin dhe interpretimin e ligjit në rastin konkret, pasi nuk ka marrë parasysh ndryshimet ligjore në lidhje me nenin 26 të VKM nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik, ku parashikohet shprehimisht se **Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.**

III.1.22. Sa më sipër, KPP gjykon, se riskualifikimi në mënyrë të përsëritur i operatorit ekonomik ankimues është kryer në shkelje të parashikimeve ligjore aktualisht në fuqi. KPP gjykon, se autoriteti kontraktor duhet të kishte verifikuar dokumentacionin origjinal të ankimuesit përpara veprimit procedural të publikimit të njoftim-fituesit në sistemin e prokurimeve elektronike. KPP e gjen veprimin e autoritetit kontraktor, jo në përputhje me parashikimet ligjore në fuqi. Akoma më tej, KPP konstaton, se autoriteti kontraktor ka kryer veprime për zvarritjen e procedurës, pasi sikundër pasqyruar më sipër, ka kryer procesin e rivlerësimit të procedurës pas afro dy muaj nga momenti i publikimit të fituesit dhe ka vijuar më tej duke kryer rivlerësime të vazhdueshme të procedurës pa asnjë mbështetje ligjore duke vendosur në fund edhe anulimin e procedurës. KPP i tërheq vëmendjen autoritetit kontraktor, për mosrespektim të dispozitave ligjore në fuqi, lidhur me momentin procedural të verifikimit të dokumentacionit origjinal dhe rivlerësimin e procedurës në shkelje të afateve ligjore dhe akoma më tej lidhur me anulimin e procedurës. KPP gjykon, se autoriteti kontraktor për procedurat e prokurimit të cilat realizon, duhet të garantojë respektimin e parashikimeve ligjore në fuqi dhe parimeve të transparencës dhe efijencës parashikuar në nenin 2 të LPP-së. Në këtë kuptim, KPP e gjen riskualifikimin e ankimuesit dhe anulimin e procedurës të pabazuar në ligj dhe në kapërcim të afateve ligjore në fuqi.

III.2. Gjithashtu, Komisioni në kushtet kur veprimet procedurale të sipërcituara të autoritetit kontraktor, nuk janë kryer në përputhje me përcaktimet ligjore dhe nënligjore në fuqi për prokurimin publik, në mbështetje të nenit 23 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i propozon Agjencisë së Prokurimit Publik nisjen e hetimit administrativ në lidhje me këto veprime procedurale.

Sa më sipër pretendimi i ankimuesit qëndron.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 261, datë 17.03.2010 “Për përcaktimin e tarifës dhe të rregullave për pagimin e saj, në një procedurë ankimi, pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik

Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Company Riviera 2008” SHPK, për procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur” me Nr. REF-05444-09-15-2021, me objekt “Rikonstruksion i segmentit Hekuran Melov, degëzimi i rrugës “Late Bregu” te pallatet dykatëshe”, me fond limit 34,008,534.7 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 08.10.2021 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Patos.
2. Autoriteti kontraktor të anulojë vendimin e KVO-së mbi skualifikimin e operatorit ekonomik “Company Riviera 2008” SHPK, si dhe të korrigjojë shkeljet, duke e kualifikuar këtë operator.
3. Autoriteti kontraktor të anulojë vendimin mbi anulimin e procedurës.
4. T’i propozojë Agjencisë së Prokurimit Publik nisjen e hetimit administrativ për konstatimet e mësipërme, si edhe të dërgohet pranë APP-së kopje e materialeve të administruara në shqyrtimin administrativ nr. 272 prot., datë 14.02.2022.
5. Autoriteti kontraktor brenda 5 ditëve të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
6. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Company Riviera 2008” SHPK.
7. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Fiorent Zguro

Anëtar
Kreshnik Ternova

Kryetar
Jonaid Myzyri